



REPUBLIKA E SHQIPERISE

KESHILLI I BASHKISE LEZHE

Bashkia, Lagja "Skënderbeu", Rruga Frang Bardhi, Lezhë – ALBANIA tel/fax: 00 355 215 2270/2268 email : keshilli@lezha.org

VENDIM

Nr 65 datë 19.12.2007

MBI

PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE KULTURORE ARTISTIKE PËR FESTAT E FUND VITIT 2007

Mbështetur në ligjin nr 8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", ligjin nr 9645 datë 26.11.2006 "Për buxhetin e shtetit për vitin 2007", Vendimin e Këshillit të Bashkisë Lezhë nr 2 datë 07.02.2007 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2007", i ndryshuar me VKB nr 25 datë 27.06.2007 "Për disa ndryshime në VKB nr 2 datë 07.02.2007", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Lezhë, pas shqyrtimit të relacionit të paraqitur dhe diskutimit të antarëve të Këshillit të Bashkisë Lezhë;

VENDOSI

1. Të pakësohet fondi rezervë në shumën prej 434.000 (katërqind e tridhjetë e katër mijë) lekë.
2. Të shtohet artikulli 602 shpenzime operative për kulturën, në shumën 434.000 (katërqind e tridhjetë e katër mijë) lekë.
3. Ky fond shtesë për kulturën të përdoret për të përballuar shpenzimet për organizimin e aktiviteteve kulturore e artistike me rastin e festave të fundvitit 2007.
4. Ngarkohet Drejtoria e Financës në aparatën e Bashkisë Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Këshilli i Bashkisë dhe konfirmimit nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

KRYETARE
ROZA HILA